

E DIELA E ORTHODOKSISE

THIRRTORET

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe tri të Triodit në Tingëllin II:

PAS IKOS TU EFRATHEA

Dit' e Konizmave, na driti o besnikë, u-shua herezia, dhe triumfoj me bujë, doktrin' e Orthodoxëve.

Çdo heretik u-shtyp, çdo shok i Ariosit, Severi Makedoni, dhe Pjetri tok me Piron, dhe ndriti një Trini me nam.

Kisha ka panair, stoliset me konizma, se Theodor' e lumur, me urdhër Perëndie, fuqin' u dha besnikëve.

LAVDI. Hiri na driti sot, e drejta e vërteta, se kor' e Shpëtimtarit, na e stolis alltarin, pra eni adhurojeni.

TANI. Zonjë Hyjlindëse, që linde Jesu Krishtin na lartësove ballën, pra ty të lavdërojmë, me besë dhe me brohori.

Pas Hyrjes këndohen Pasvargjet e Tingëllit. Pastaj:

LAVDI. Le t'i trokasim duartë, dhe le ta përhirojmë Perëndinë, se duallmë nga errësira në dritën, dhe nga herezia në besën e vërtetë. Le t'i adhurojmë me besë, konizmat e shenjta të Krishtit, të Shën Marisë dhe të gjithë Shenjtorëve, se Shën Vasili thotë që ky nderim u bëhet origjinaleve, dhe le t'u lutemi të na dhurojnë përdëllimin e math.

TANI. *E Tingëllit.*

Pas Përlëshores së Tingëllit këndohet:

PERLESHORJA E KONIZMAVE, T.II.
TIN AKHRANTON IKONA SU

Konizmën e bekuar po adhurojmë besërisht, dhe ndjesë po të lypim për fajet edhe mëkatat tona o Krisht Perëndi, se deshe dhe dignove të mbërthehesh mi Kryqin trupërisht, dhe nga zgjedha e djallit na shpëtove dhe na dhe liri; pra po të thërresim me përhirim. Me gas i mbushe që të gjitha Shpëtimtar Jesu, se ti ke ardhur për shpëtimin e botës.

SHKURTORJA, T. T. IV.

I papërshkruari Fjal' e Perëndi, u-mishërua prej teje o Zonjë Hyjlindëse, dhe e riformoj, dhe e ringjalli njerin' e rëzuar, dhe ia dha prapë bukurinë e perëndishme. Po dyke treguar shpëtimin, përsëritim historinë me fjalë dhe me vepra.

SHTEPIA

Profetët e frymësuar prej Perëndisë, na e parëlajmëruan misterin e ekonomisë. Passi e muarmë këtë revellatë, njohim një Zot, një Perëndi, të cilin e lavdërojmë në tri fytyra, dhe e adhurojmë si një personë, edhe kemi një Besë dhe një Pagëzim, edhe jemi veshur me Krishtin. Po dyke treguar shpëtimin, e përsëritim historinë me fjalë dhe me vepra.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Parë të Kreshmëve, kujtojmë ristratorën e Korëve të Shenjta, e cila u-bë prej perandorit të kujtuarshmë të Kostantinopojës Mëhill edhe

Nënës së tij Theodora, kur ishte Patrik Shën Methodi Konfessori.

Gjithë sot kujtojmë Meshën e parë në gjuhën Shqipe prej At Fan Nolit më 1908 në Boston, Mass., të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

O Korë e pandryshuar e Atit, me nërmjetimet e Konfesorëve të Shenjtë, mëshirona dhe shpëtona, Amin.

Pastaj Zbritësoret: "Ja gojën e çel tani." Pas Dërgimësore
Ngjallësore, këndohen:

DERGIMESORET, T. II

PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Eni trokisni duartë, këceni dhe këndon: Sa vepra të çudiçime, ke mbaruar për botën, o Zoti Krisht jetëdhënës, se na i mbylle sherret, edhe na solle një pajtim, dhe i mblodhe besnikët për një bashkim, dhe na i stolise Kishët e Shenjta, me korët e bekuara, pas fesë Orthodokse.

O Krijetar i botëve, o Zot i gjithësisë, prej Shën Marisë more trup, dhe njeri pa ndryshuar, për njerëzit na u-bëre, na përsërite shpirtin, të prishur prej mëkatave, ti që linde prej Nënë çuditërisht, pra thërresim besërisht që të gjithë, me lavdërim dhe brohori: Zonj' e jetës gëzohu.

LAVDERIMET

Këndohen tetë Tropare, domethënë pesë të Tingëllit edhe tri të Përshëmbëllta të Triodit në Tingëllin I:

PAS TON URANION TAGMATON

Na driti dhe na shkëlqeu Orthodoksia sot, e çporri errësirën, edhe ren' e gënjeshtres, kremtojmë pra me buj' e me ngazëllim, dhe me besë përgjunjemi, dhe adhurojmë konizmat e Zotit Krisht, nëpër Kishët e stolisura.

E zbukuruar me korët e rivëndosura, si nuse e stolisur, Kish' e Zotit gëzohet, besnikët i përmbledh kudo për kremtim, eni pra dhe përgjunjuni, me ngazëllim dhe me besë dhe me bashkim, madhështojeni Zotin Krisht.

E tërë bota gëzohet se Zot' i Forcave, nga qjelli e përmbysi herezin' e paudhë, dhe korët i vëndosi prapë n' alltar, dhe në Kishët me brohori, eni besnik' Orthodoksë me ngazëllim, këtë ditë kremtojeni.

LAVDI, T.T.II: Moisiu në kohën e përkorës, e priti Ligjën e Zotit, edhe e ndriti popullin; Shënt Elliu agjëroj, dhe e mbylli qiellin; Tre Djemat Abramianë, e muntne me kreshmë, tiranin e paudhë. Me këtë o Zot edhe ne vlerësona, ta gëzojmë Pashkën, dyke thirrur kështu: Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, mëshirona.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlindëse Virgjëreshë. . . .

Doksollogji e Madhe. Në Hyrjen Përlëshorja e Tingëllit, pastaj:

PERLESHORJA E KOREVE, T.II. TIN AKHRANTON IKONA SU

Konizmen e bekuar po adhurojmë besërisht, dhe

ndjesë po të lypim për fajet edhe mëkatat tona o Krisht Perëndi, se deshe dhe dignove të mbërthehesh mi Kryqin trupërisht, dhe nga zgjedha e djallit na shpëtove dhe na dhe liri; pra po të thërresim me përhirim: Me gas i mbushe që të gjitha Shpëtimtar Jesu, se ti ke ardhur për shpëtimin e botës.

Përlëshorja e Shenjtit të Kishës, pastaj:

SHKURTORJA, T. T. IV.

TI IPERMAKHO STRATIGO

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse,
Si përhirim që e shpëtove prej tmerreve,
Populli yt po të përshkruan o Virgjëreshë;
Po sikundër ke fuqi të palëftuarshme,
Prej çfarëdo reziku shpëto-më,
Se po të thërres: Gëzohu o nuse e panusëruar.

APOSTULLI

I bekuar je, o Zot, o Perëndi i Atërve tanë.

Se je i drejtë më të gjitha sa na bëre.

Këndimi prej Letrës së Palit për Romanët.

Vëllezër, Moisiu u-bë i math me anën e besës, dhe refuzoj të quhej i biri i së bijës së Faraonit; po preferoj të vuante bashkë me popullin e Perëndisë se sa të kishtë një gëzim të përkohëshme të mëkatit; se dhunën e Krishtit e quante një pasuri më të madhe se thesaret e Egyptës, se e kishte syrin në çpagimin e rogës. Dhe ç' të them edhe? Se do më mungonjë koha, sikur të tregonj për Gedeonin, Barakun, Samsonin, Jefthaen, Davidin,

Samuelin, dhe Profetët; të cilët me besën përmbysnë mbretëria, vepëruan drejtësi, mbëçelnë gojë luanësh, shuan forcë zjarri, shpëtuan nga lëpitka e shpatës, u-forcuan prej dobësisë, u-treguan të fortë në luftë, i çakërdisnë ushtërit' e huaja. Gratë pritrnë të vdekurit e tyre prej ngjalljes; të tjerë u-munduan dhe refuzuan çlirimin që të presin ngjallje më të mirë; të tjerë u-provuan me tallje dhe kamçike, me vargonj, dhe me burgje; u-lapiduan, u-sharruan, u-nganë, u-thernë me shpatë; shetitnë me lëkurë delesh e dhish, të varfëruar, të helmuar, të munduar (për të cilat nuk ishte e vyer bota), të arratisur në shkretëtirat edhe malet edhe shpellat edhe vrimat e dheut. Edhe këta të gjithë, ndonëse dëshmuan për besën, nuk e muarnë zotimin e Perëndisë, i cili parëshikoj një gjë më të mirë për ne, që të mos perfekttohëshin pa ne.

UNGJJILLI PAS JOANIT

M' atë kohë, Jesuj deshi të shkonte në Galile; edhe e gjeti Filipin, dhe i tha: "Eja pas meje." Dhe Filipi ishte nga Bethsaida, qyteti i Andreut edhe i Pjetrit. Filipi e gjeti Nathanielin, edhe i tha: "E gjetmë Jesunë, të birin e Josefit nga Nazareti, për të cilin kanë shkruar Moisiu dhe Profetët në ligjën." Edhe Nathanaeli tha: "A munt të vinjë nonjë e mirë nga Nazareti?" Edhe Filipi iu-përgjey: "Eja dhe shih." Edhe Jesuj e pa Nathanaelin, që i vinte, dhe tha për atë: "Ja një Israelit i fjeshtë pa djallëzi." Edhe Nathanaeli e pyeti: "Që nga më njeh?" Edhe Jesuj iu-përgjey: "Përpara se të të thërriste Filipi, të pashë që ishe nënë fikun." Edhe Nathanaeli i tha: "O Zot, ti je i Biri i Perëndisë, ti je Mbreti i Israelit." Edhe Jesuj iu-përgjey: "Se te thashë që të kam parë nënë fikun, më besove? Do të shikosh

gjëra më të mëdha se kjo.” Edhe pastaj i tha: “Që tani e tutje do ta shikosh qjellin të hapet, edhe Engjëjt’ e Perëndisë të hipin e të zbresin mi të Birin e njeriut.”

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Basilit.